



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Nr. 300/12 prot

Datë 09.04.2024

V E N D I M

Nr. 360/2024

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Jonaid Myzyri	Kryetar
Anila Malaj	Anëtar
Kreshnik Ternova	Anëtar

Në mbledhjen e datës 09.04.2024 me

Objekt: Shfuqizimi i vendimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave për kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatorët ekonomikë “Trimed” SHPK në procedurën e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-93011-01-11-2024, me objekt: “*Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*”, me fond limit 7,137,795 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 23.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

Autoriteti Kontraktor: Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë, me adresë: Lagja “18 Shtatori”, Gjirokastrë.

Ankimues: Bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK, me NIPT (J61827062E) & “Montal” SHPK me NIPT (J62009007F), Bulevardi “Zhan D’Ark”, Pallati Nr.53, Ap.6B, Tiranë.

Subjekte të Interesuara: Operatori ekonomik “Trimed” SHPK, me NIPT (K51612031J), me adresë: Autostrada Tiranë - Durrës, Km.10, Godine 3 Katëshe, Kashar, Tiranë.

Baza Ligjore: Nenet 30 dhe 115 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, dhe nenit 4 të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 05.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi shqyrtoi informacionin e paraqitur

Vëren:

I

Vlerësimi Paraprak

I.1. Vlëra limit e përlogaritur për procedurën e prokurimit objekt-ankimi është mbi kufirin e ulët monetar, ndaj shqyrtimi dhe vendimmarrja do të bëhet nga të gjithë anëtarët, në përputhje me pikën 1, të nenit 30 të ligjit nr. 162/2020 “Për prokurimin publik” dhe Rregullat e Prokurimit Publik.

I.2. Operatori ekonomik ka *prima facie* interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të.

I.3. Operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor dhe njëherazi pranë Komisionit të Prokurimit Publik, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”.

I.4. Ankimuesi ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik.

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 12.01.2024, është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, procedura e prokurimit “*Procedurë e hapur, e thjeshtuar*”, me Nr. REF-93011-01-11-2024, me objekt: “*Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)*”, me fond limit 7,137,795 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 23.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastrë.

II.2. Në datën 31.01.2024, autoriteti kontraktor ka njoftuar operatorët ekonomikë pjesëmarrës me anë të sistemit të prokurimeve elektronike (S.P.E.), mbi rezultatet e vlerësimit të Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, të cilët kanë paraqitur ofertat ekonomike (pa TVSH), përkatësisht:

- | | |
|---|-----------------------------------|
| 1. “Trimed” SHPK | 6.543.923 lekë, kualifikuar |
| 2. BOE “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK | 6.996.900 lekë, kualifikuar |
| 3. “Aquarius Medival” SHPK | Nuk ka paraqitur ofertë ekonomike |

II.3. Në datën 02.02.2024, autoriteti kontraktor ka publikuar njoftimin e fituesit paraprak në SPE.

II.4. Në datën 07.02.2024, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, është dorëzuar ankesa me nr. protokoll 300/2024, datë 07.02.2024, e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK, për procedurën e prokurimit.

Nga shqyrtimi paraprak i ankesës së sipërcituar, u konstatua se objekti i ankesës lidhet me vendimmarrjen e Komisionit të Vlerësimit të Ofertave, mbi kualifikimin e ofertës së paraqitur nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK. Konkretisht në ankesën e tij, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimes pretendon: “*[...] Nisur nga pervoja jone shumevjecare ne treg si BOE, duke qene nga kompanite qe kane fumizuar prej vitesh spitalet e Shqiperise me materiale mjekimi spitalore objekt te kesaj procedure prokurimi, paraqesim dyshimin tone te arsyeshem dhe pretendimin tone qe produktet e ofruara nga kompania Trimed shpk nuk plotesojne kriteret, specifikimet dhe standardet e kerkuara ne DST. Ngrejme dyshimet tona te bazuara ne faktet e meposhtme qe KVO nuk ka bere nje vleresim te drejte dhe korrekt ne kontrollin e dokumentacionit dhe mostrave qe kjo kompani ka paraqitur ne kete procedure prokurimi si dhe perputhjen me kerkesat per kualifikim te DST.*

Per kete arsye, bazuar ne Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik dhe Udhezimin e Agjencise se Prokurimit Publik Nr. 03 date 12.04.2022, kerkojme nga KSHA dhe KPP qe te kryhet verifikimi dhe kontrolli i detajuar i dokumentacionit te paraqitur nga kompania Trimed shpk, (sipas kriterëve 2.3.3, 2.3.4, 2.3.6, 2.3.8 te kerkuar ne DST) sic jane: Autorizimet e prodhuesve, Certifikatat ISO 13485:2016 ose ISO 9001:2015 per prodhuesit, Certifikatat CE dhe Deklarata konformiteti, Kataloget e paraqitur per produktet e ofruara, dhe te behet krahasimi i tyre me mostrat e prezantuara ne tender nga kjo kompani.

Sipas pikes 2.3.9 / 3 te percaktuar ne DST: 2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal

Gjirokaster, të mbyllura me ngjithëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « Materiale mjekimi të pergjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”» dhe jo para datës 23.01.2024 ora 11 :00.

3. - Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.

4. - Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).

5. - Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1). lutemi që të behet verifikimi i perpuethshmerise se origjines, kompanive prodhuese dhe kodeve të shenuara ne etiketen e mostrave, me origjinat dhe kompanite prodhuese te prezantuara ne formularin e ofertes (shtojca 1), si dhe ato te paraqitura ne dokumentacionin perkates te paraqitur nga OE Trimed shpk, pra ne certifikatat e konformitetit dhe ne kataloget respektive.

Qe nje oferte te konsiderohet e rregullt dhe sipas kerkesave ne DST, nevojitet qe te gjithe elementet e mesiperme te jene korrekte dhe ne perpuethshmeri me njeri tjetrin, cka do te thote qe:

1. Kompanite prodhuese dhe origjina mbi paketimin e cdo mostre (te cilat duhet te evidentohen qarte) duhet te jene te njejta me origjinen dhe prodhuesit e deklaruar ne formularin e ofertes.

2. Te verifikohet qe nga Prodhuesi i evidentuar mbi paketimin e mostres dhe ne formularin e ofertes, eshte marre Autorizim i rregullt drejtuar kompanise Trimed shpk per shitjen e produkteve objekt prokurimi ne territorin e Shqiperise.

3. Prodhuesit perkates te evidentuar ne katalogun e paraqitur te jene te njejte me ata te paraqitur ne oferte, dokumentacion dhe paketimin e mostrave.

4. Kodet e produkteve mbi paketimin e mostrave duhet te jene ne perputhje me kodet e paraqitura ne kataloget perkates si dhe ne Certifikatat CE te konformitetit (sipas kategorizimit perkates).

5. Specifikimet e markuara ne Catalog te jene ne perputhje te plote me specifikimet teknike te artikujve te kerkuar ne DST.

Ne lidhje me kete pike kerkojme verifikimin e plotesimit te specifikimeve teknike per te gjithe artikujt e ofruar dhe ne vecanti per artikujt sipas numrit rendor te meposhtem:

3	Bende elastike 7.5cm x 4m	100% pambuk elastik, pesha 80-90g/cm ²
17	Hemostatik kolageni i absorbueshem	Siperfaqe 100-110 cm ² , me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm ² fibrile kolagjeni ose ekuivalent
18	Garze abdominale	Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensionin e nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te

		<i>qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako</i>
33	<i>Absorbues CO2 per Anestezi</i>	<i>Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.</i>
41	<i>Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500-800ml Komplet redoni G 12-22</i>	<i>Set=(ballon vakumi+form z fold tub+dren+troakar)</i>
48	<i>Dren abdominal double drain me katere te brendshem</i>	
51	<i>Set steril per funksionim vezike urinare</i>	<i>I perbere nga kateter silikoni me ballon, Ch 10-15 L= 40-70 cm, me introduktor te hapshem</i>
71	<i>Set epidural</i>	<i>kateter 19G/20G+age epidurale+gide +filter+shiringe</i>
73	<i>Kateter arterial</i>	<i>20G-22G Seldinger</i>
85	<i>Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi</i>	<i>Ch 8, 10</i>
86	<i>Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi</i>	<i>Ch 12, 14, 16, 18.</i>
97	<i>Set punkcioni pleural</i>	<i>Set i perbere nga age veres, kateter drenimi 9-12Fr gjatesi 40÷50cm, qese drenimi min.2000ml, me valvul hyrese dhe shkarkimi.</i>
124	<i>Set Filter spirometrik antibakterial</i>	<i>Set i perbere nga: filter antibakterial, gojez spirometrike, dhe klipi nasal</i>

Me pergjegjesi deklarojme qe specifikimet per artikujt si me poshte nuk permbushen nga oferta e OE Trimed shpk

17	<i>Hemostatik kolageni i absorbueshem</i>	<i>Siperfaqe 100-110 cm2, me origjine nga tendinet e kuajve, 2.8 mg/cm2 fibrile kolageni ose ekuivalent</i>
----	---	---

18	<i>Garze abdominale</i>	<i>Garze sterile, e detektueshme nga rrezet-x, 100% pambuk absorbent, me 6 pala, dimensiononi i nje pale 45x45cm, dendesia 28x28, me funde te qepura, me lak lidhes, jo me shume se 5 cope per pako</i>
33	<i>Absorbues CO2 per Anestezi</i>	<i>Permbajtja: Hidroxid Calciumi dhe Natriumi. Granulariteti 3÷5 mm. pH: 12 - 14. Ndryshim ngjyre pas saturimit me CO2.</i>
51	<i>Set steril per funksionim vezike urinare</i>	<i>I perbere nga kateter silikoni me ballon, Ch 10-15 L= 40-70 cm, me introduktor te hapshem</i>
73	<i>Kateter arterial</i>	<i>20G-22G Seldinger</i>
85	<i>Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi</i>	<i>Ch 8, 10</i>
97	<i>Set punkcioni pleural</i>	<i>Set i perbere nga age veres, kateter drenimi 9-12Fr gjatesi 40÷50cm, qese drenimi min.2000ml, me valvul hyrese dhe shkarkimi.</i>

6. Produktet e ofertuara duhet te jene te pasqyruara me emertimet perkatese ne Certifikatat CE dhe Deklaratat e Konformitetit sipas prodhuesve te deklaruar ne oferte.

7. Certifikatat CE te jene te rregullta sipas Direktivave perkatese dhe te vlefshme ne daten e hapjes se tenderit, ose ne rast se kane kaluar daten e skadences te jene te shoqeruara me Dokument Konfirmimi nga Organi Certifikues per zgjatje te vlefshmerise sipas Rregullores (EU) 2023/607 te Keshillit Europian.”

Per te gjitha pikat e mesiperme, bazuar ne pervojat tona te meparshme, ne si BOE ngrejme dyshimet tona te arsyeshme qe ato nuk permbushen nga OE Trimed shpk, dyshime te cilat perforcohen me mungesen e transparences nga Autoriteti Kontraktor dhe faktin qe KVO nuk pranoi qe mostrap e kesaj kompanie te hapeshin dhe verifikoheshin ne daten dhe oren e zhvillimit se tenderit, ne kundersizim me Udhezimin e Agjencise se Prokurimit Publik Nr. 03 date 12.04.2022.

Sipas pikes 3 te ketij Udhezimi, ne rast se ndonjera nga palet ka komente/pretendime ato duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbajtur.

“Sipas pikes 3 te ketij Udhezimi, ne rast se ndonjera nga palet ka komente/pretendime ato duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbajtur.

KVO ne prezence te perfaqesuesit tone, nuk ka pranuar te pasqyroje ne procesverbalin e mbajtur me ne si BOE, pretendimet tona per parregullsi ne menaxhimin e mostrave, duke mos e marre fare ne konsiderate kerkesen tone e cila eshte ne perputhje me Udhezimin e Agjencise se Prokurimit Publik Nr. 03 date 12.04.2022.

Procesverballi i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet të vihet në dispozicion ofertuesit/ve.

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/prezime, ato duhet të pasqyrohen në procesverballin e mbajtur.

Sipas kesaj pike gjithashtu, AK duhet të mbaje procesverbale me të gjithë ofertuesit me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetin e procesit i cili duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara, nderkohe që ky procesverbal i cili duhet të nënshkruhet nga palët e pranishme (përfaqësuesi/it i AK dhe ofertuesit/ve) nuk është mbajtur nga ana e AK, sipas Udhezimit të APP.

Per sa me sipër, KVO ka vepruar me njëanshmeri dhe vleresim të padrejte në këtë procedurë prokurimi, në kundërshtim me Nenin 2 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 për Prokurimin Publik, qëllimi i të cilit është

d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;

dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

Mostrat e OE Trimed shpk nuk janë administruar sipas udhezimit të APP në ditën dhe orën e tenderit dhe paketimet e tyre nuk janë verifikuar me detaje nga ana e AK dhe KVO, kjo në mungesë të plote të transparencës. Administrimi në kundërshtim me udhezimin e APP natyrshëm ka krijuar kushtet për favorizim të ofertës së OE Trimed shpk duke mos evidentuar mosperputhje të këtyre mostrave me artikujt e deklaruar në formularin e ofertës, mosperputhje të këtyre mostrave me artikujt e markuar në katalog, mosperputhje të këtyre mostrave me prodhuesit e deklaruar në oferte dhe në autorizime si dhe mosperputhje të këtyre mostrave me produktet e përfshira në certifikatat përkatëse të konformitetit CE.

Bazuar në Nenin 81 të Ligjit Nr. 162/2020 datë 23.12.2020 për Prokurimin Publik (E drejta për informim), në datën 05.02.2024 në i kemi drejtuar gjithashtu me një kërkesë autoritetit kontraktor nepermjet postës elektronike (e-mail bashkelidhur) për të na vënë në dispozicion dokumentacionin e paraqitur nga operatori Trimed shpk si Kataloget teknike për të gjithë artikujt e ofruar dhe Procesverballin e administrimit të mostrave, dhe deri në datën e paraqitjes së kesaj ankese nuk kemi marrë një përgjigje nga ana e AK. Kërkesa jonë është e përlytur në parashikimet e DST, Shtojca 4 ku citohet se: Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkëlqim të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dhe parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial. çmimin e ofertës, listën e çmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes së ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera që duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjislacionin në fuqi.

Mungesa e vendosjes në dispozicion të katalogëve, të cilat referuar legjislacionit të prokurimit publik si dhe parashikimeve të Kontratës Publike të shpallur nga AK për këtë objekt prokurimi janë informacion që AK duhet të na i kishte vendosur në dispozicion, na çon në pamundësi që të saktësojmë konkretisht artikujt duke u referuar në katalogun e paraqitur nga OE i renditur

i pari, pra të saktësojmë mospërputhjen për sa i përket certifikimeve CE si dhe faktin nëse janë shoqëruar me çertifikatë CE apo jo.

Sjellim në vëmendje që për disa nga artikujt, referuar kategorisë si materiale mjekësore, është e detyrueshme pajisja me çertifikatë CE (për produktet e klasës II dhe klasës I sterile ose funksion matës) dhe jo pajisja me vetëm deklarata të konformitetit (e aplikueshme vetëm për produktet e klasës I josterile).

Në përputhje me Direktivën 93/42/EEC, për pajisjet mjekësore të klasës III, përveç Çertifikatës CE (Full Quality Assurance) nevojitet edhe pajisja me Çertifikatë CE Design-Examination, paraqitja e së cilës duhet të verifikohet përsa i përket një prej artikujve të mëposhtëm.

Produktet objekt prokurimi të cilat kërkojnë pajisjen me Çertifikatë CE (lëshuar nga një Organ Çertifikues) janë në tabelën në vijim:

<i>Nr</i>	<i>Artikulli</i>	<i>Klasifikimi</i>
9	<i>Bende me parafine 10x10cm</i>	<i>Klasa IIb</i>
10	<i>Komprese sterile 5cm x 5cm</i>	<i>Klasa I sterile</i>
11	<i>Komprese sterile 10cm x 10cm</i>	<i>Klasa I sterile</i>
13	<i>Komprese sterile 10cm x 20cm</i>	<i>Klasa I sterile</i>
14	<i>Komprese sterile 10cm x 10cm</i>	<i>Klasa I sterile</i>
17	<i>Hemostatik kolageni i absorbueshem</i>	<i>Klasa III (plus Certificate Ekzaminim-Dizajni)</i>
27	<i>Sisteme infuzioni</i>	<i>Klasa Ha</i>
29	<i>Doreza kirurgjikale sterile (ndare sipas numrit)</i>	<i>Klasa Ha</i>
30	<i>Lama bisturie</i>	<i>Klasa Ha</i>
31	<i>Filter baktericid</i>	<i>Klasa Ha</i>
32	<i>Qarqe respiratori</i>	<i>Klasa Ha</i>
33	<i>Absorbues CO2 per Anestezi</i>	<i>Klasa Ha</i>
36	<i>Sonde oksigjeni adult</i>	<i>Klasa Ha</i>
39	<i>Komplet aerosoli me tub zgajtues 1.5m</i>	<i>Klasa Ha</i>
41	<i>Set drenimi Redon me vakum ne forme fizarmonike 500 800 Ko let edon G 2</i>	<i>Klasa Ha</i>
43	<i>22 Dren silikoni</i>	<i>Klasa Ha</i>
47	<i>Dren torakal I drejte dhe anguluar</i>	<i>Klasa Ha</i>
48	<i>Dren abdominal double drain me katere te brendshem</i>	<i>Klasa IIb</i>
51	<i>Set steril per funksionim vezike urinare</i>	<i>Klasa IIb</i>
59	<i>Lageshtues per CPAP</i>	<i>Klasa IIb</i>
71	<i>Set epidural</i>	<i>Klasa Ha</i>
73	<i>Kateter arterial</i>	<i>Klasa IIa</i>
76	<i>Urinokol pediatrik</i>	<i>Klasa I sterile</i>
77	<i>Kapese kordoni umbilikal</i>	<i>Klasa I sterile</i>
79	<i>Tub ushqimi pediatrik</i>	<i>Klasa Ila</i>

81	<i>Tuba endotrakeale pediatrike</i>	<i>Klasa Ha</i>
82	<i>Tuba endotrakeale adult</i>	<i>Klasa Ila</i>
83	<i>Kateter aspirimi pediatrik</i>	<i>Klasa Ila</i>
84	<i>Kateter aspirimi adult</i>	<i>Klasa Ila</i>
85	<i>Kateter aspirimi pediatrik me kontroll vakumi</i>	<i>Klasa Ha</i>
86	<i>Kateter aspirimi adult me kontroll vakumi</i>	<i>Klasa Ha</i>
89	<i>Tub endotrakeal 7.5</i>	<i>Klasa Ila</i>
90	<i>Tub endotrakeal 8.0</i>	<i>Klasa Ha</i>
91	<i>Maske Laringeale PVC</i>	<i>Klasa Ha</i>
92	<i>Maske Laringeale Silikon</i>	<i>Klasa Ha</i>
96	<i>Spekulum vaginal</i>	<i>Klasa I sterile</i>
97	<i>Set punkcioni pleural</i>	<i>Klasa Ha</i>
115	<i>Aparat tensioni</i>	<i>Klasa I me funksion mates</i>
118	<i>Termometer</i>	<i>Klasa I me funksion mates</i>
119	<i>Spatula I druri 4</i>	<i>Klasa I sterile</i>
122	<i>Gojez spirometrike</i>	<i>Klasa Ha</i>
123	<i>Filter spirometrik antibakterial</i>	<i>Klasa Ha</i>
124	<i>Set Filter spirometrik antibakterial</i>	<i>Klasa Ha</i>
140	<i>Sisteme Transfuzioni Gjaku</i>	<i>Klasa Ha</i>

“2.3.6. Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, për tregëtimin e artikujve të ofruar Shënim: Në rastin e distributorit të autorizuar për Shqipërinë të provohet lidhja me prodhuesin nëpërmjet dokumentacionit përkatës”,

Pra siç kemi kërkuar më sipër, sqarojmë gjithashtu se në këto Dokumente Tenderi, AK ka kërkuar specifikisht që OE, në mënyrë që të kualifikohet, duhet detyrimisht të plotësojë dy kushtet kumulative të përcaktuara në pikën 2.3.6 ku citojmë: 6Operatori ekonomik duhet të paraqesë autorizim nga kompania prodhuese ose nga Distributor të Autorizuar nga prodhuesi, për Shqipërinë, për këtë procedurë prokurimi, pra kushti i parë që duhet të plotësohet është ai i autorizimit që duhet të paraqesë OE nga 1) Prodhuësi, ose 2) Distributori i Autorizuar nga Prodhuësi, ndërsa kushti i dytë që duhet të plotësojë OE, është që autorizimi i paraqitur nga Distributori, në mënyrë që të jetë i vlefshëm, kërkon që ky i fundit, të jetë distributor i autorizuar për Shqipërinë, rasti i mosqënies si distributor i autorizuar për Shqipërinë, sjell për pasojë mosplotësimin e njërit nga dy kushtet kumulative të detyrueshme për tu plotësuar gjatë ofertimit, për pasojë pavlefshmërinë e ofertës së paraqitur. Sqarojmë KSHA se kriteret e veçanta për

kualifikim kanë si synim kryesor që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për njohjen e gjendjes dhe kapaciteteve të operatorëve ekonomikë, të cilët, nëpërmjet dokumentacionit të paraqitur duhet të vërtetojnë se zotërojnë kualifikimet e nevojshme teknike, profesionale, kapacitetet ekonomike, financiare dhe organizative, makineritë, pajisjet e asete të tjera fizike, reputacionin dhe besueshmërinë, përvojën e duhur, si dhe personelin e nevojshëm, gjithçka në funksion të realizimit me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët Ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tendent dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme.

Per sa me siper, kerkojme nga KSHA dhe me tej KPP, qe ne zbatim te Ligjit Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Vendimit Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik dhe Udhezimit e Agjencise se Prokurimit Publik Nr. 03 date 12.04.2022, te behet verifikimi i detajuar i procesverbaleve te mbajtura nga ana e KVO, verifikimi i listes se mostrave te paraqitura nga Trimed shpk, nese ato jane ne perputhje me dokumentacionin e permendur ne argumentimin me lart, verifikimi i specifikimeve teknike te markuara ne katalog me ato te kerkuara ne DST, si dhe verifikimi i dokumentave te faktit, ligjore dhe teknike te paraqitur nga OE Trimed shpk ne kete procedure prokurimi.

Kerkojme skualifikimin e ofertes te OE Trimed shpk duke e cilesuar ate si jo te rregullt dhe ne kundërshtim me kriteret e percaktuara ne DST, Ligjin Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik, Vendimin Nr. 285, datë 19.5.2021 Për Miratimin e Rregullave të Prokurimit Publik si dhe Udhezimin e Agjencise se Prokurimit Publik Nr. 03 date 12.04.2022.”

II.5. Në përputhje me nenin 112 “Veprimet paraprake” të Ligjit nr.162/2020 “Për Prokurimin Publik”, me marrjen e ankesës, Komisioni i Prokurimit Publik e publikoi atë në bazën e të dhënave të tij, e cila përmban të dhëna për: a) ankimesin, adresën dhe NUIS-in; b) të dhëna të plota për procedurën e prokurimit (objekt, numër reference, fond limit, datën e zhvillimit të procedurës), si dhe është publikuar formulari i publikimit Nr. Prot., 300/2, datë 08.02.2024, lidhur me kriteret për të cilat bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK me anë të ankesës së tij, pretendon se nuk përmbushen nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, pjesëmarrës në procedurën e prokurimit.

II.6. Me shkresën nr. 65/9 prot, datë 15.02.2024, protokolluar me tonën me nr.300/5 prot., datë 19.02.2024, me objekt: “Njoftim për ndërprerje të afatit për shqyrtimin e ankesës” autoriteti kontraktor informon se: “Bazuar në nenin 114, pika 2 të Ligjit nr. 162 dt 23.12.2020 Për prokurimin publik dhe nenin 100 të VKM Nr.285, datë 15.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, ju njoftojmë se afati për shqyrtimin e ankesës për procedurën e prokurimit me objekt “Materiale mjekimi të pëtgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të paracaktuara – me afat 1 vjeçar (12 muaj), do të ndërpritet dhe do të rifillojë pasi të sigurohet informacioni nga organet e tjera, nisur nga nevoja e AK që të kryejë verifikime pranë subjekteve dhe organeve përkatëse për dokumente mbi të cilat ka dyshime të arsyeshme, si dhe për hetim më të detajuar të pretendimeve të ngritura nga të dy operatorët.”

II.7. Me shkresën nr. 416 prot, datë 18.03.2024, me objekt: “*Shkresë përcjellëse*”, protokolluar me tonën me nr. 300/6 prot. datë 20.03.2024, autoriteti kontraktor ka dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik “*Vendimin e Komisionit të Shqyrtimit të Ankesës*” datë 18.03.2024, ku konstatohet, se ankesa e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues është refuzuar.

II.8. Në datën 25.03.2024, me anë të shkresës me objekt “*Shkresë për shtim argumentesh në vijim të ankesës Nr. Prot. 300/2024 dhe në përgjigje të Vendimit të KSHA “Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër” me Nr. 416 Prot., datë 18.03.2024*”, protokolluar me tonën me nr.300/7 prot., datë 25.03.2024, bashkimi i operatorëve ekonomik ankimues ka paraqitur pranë KPP-së argumenta shtesë mbi ankesën e tij.

II.9. Me anë të shkresës nr.300/8 prot., datë 26.03.2024, me objekt “*Mbi detyrimin e autoritetit kontraktor për dhënie informacioni KPP-së lidhur me ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK*”, Komisioni i Prokurimit Publik i ka kërkuar autoritetit kontraktor informacion mbi procedurën e prokurimit, si dhe dorëzimin e mostrave të operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, konkretisht: “[...] *Sa më sipër, referuar pretendimeve të bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, krahas informacionit të mësipërm, KPP kërkon nga autoriteti juaj të dorëzoni pranë institucionit tonë mostrat e paraqitura për këtë procedurë prokurimi, nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre, procesverbalin e mbajtur nga autoriteti kontraktor për administrimin e tyre, si dhe informacion të hollësishëm në lidhje me procedurën e mësipërme të prokurimit.*”

II.10. Me shkresën nr. 468/1 prot, datë 02.04.2024 me objekt: “*Shkresë përcjellëse*” protokolluar me tonën me nr. 300/9 datë 03.04.2024, janë dërguar pranë Komisionit të Prokurimit Publik, mostrat e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, së bashku me dokumentacionin shoqërues të tyre.

II.11. Në datën 13.02.2024, operatori ekonomik “Trimed” SHPK, si subjekt i interesuar në këtë procedurë prokurimi, ka paraqitur nëpërmjet Sistemit të Ankesave Elektronike, si dhe në formë shkresore, Formularin e paraqitjes së argumenteve, në përputhje me nenin 113, ligji Nr. 162/2020 “*Për Prokurimin Publik*”.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur saj, si dhe informacionit të autoritetit kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimet e bashkimit të operatorit ekonomik ankimues “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK për skualifikimin e operatorit ekonomik “Trimed” SHPK, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton, se në ankesën drejtuar pranë autoritetit kontraktor dhe pranë KPP, bashkimi i operatorëve ekonomikë ankimues nuk parashtron fakte apo dyshime të bazuara, por ngre pretendime *a-priori*, duke ngritur dyshime e hamendësime, lidhur me plotësimin e kriterëve të kualifikimit dhe specifikimeve teknike nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK në procedurën e prokurimit objekt - ankimi.

Referuar Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766/2021, datë 13.10.2021 “*Për miratimin e rregullave për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik*”, Komisioni i Prokurimit Publik shqyrton paraprakisht ankesën nga ana formale, duke verifikuar (krahas juridiksionit administrativ dhe kompetencës lëndore, legjitimitetit të ankimuesit dhe respektimit afateve), edhe “elementet e domosdoshme të ankesës” sipas përcaktimeve të nenit 48, “Kushtet formale të ankesës”, pika 3:

Ankesa, sipas rastit, mund të shoqërohet edhe me: a) provat dokumentare, të cilat ankimuesi kërkon të shqyrtohen nga Komisioni”.

Bazuar në sa më sipër, KPP gjykon, se ankimuesi duhej të kishte shoqëruar pretendimet e tij me prova, indicie dhe argumente, në bazë të të cilave do të shqyrtohen këto pretendime. Vlen të ritheksojmë, se Komisioni i Prokurimit Publik është organi më i lartë administrativ, i cili në kuptim të nenit 90 të LPP dhe nenit 80 të VKM nr. 285, datë 19.05.2021 “*Për miratimin e rregullave të prokurimit publik*”, shqyrton ankesat mbi vendimet e marra nga KVO e autoritetit kontraktor, por ligjvënësi qartazi i ka ndarë detyrat dhe kompetencat e këtyre dy organeve. Operatori ekonomik ka detyrimin që ta bëjë të identifikueshëm pretendimin e tij mbi shkeljen e pretenduar, pra të evidentojë qartë dhe saktë se ku e bazon pretendimin e tij. Është barrë e operatorit ekonomik që të përcaktojë, se në cilin fakt apo rrethanë e mbështet pretendimin e tij për kualifikimin e padrejtë të shoqërisë “Trimed” SHPK. Një ankim në total, pa argumente të arsyeshme apo indicie të qarta, mbi të gjitha apo shumicën e elementeve përbërëse të dokumenteve të tenderit, do të konsiderohet abuziv, në kundërshtim me qëllimin e veprimtarisë së Komisionit, pasi cenon efikasitetin dhe shpejtësinë e procedurës së prokurimit publik dhe nuk do të merret në shqyrtim nga KPP.

KPP është paraparë nga ligji si një *quasi* gjykatë. Si i tillë në vendimmarrjen e tij, Komisioni i Prokurimit Publik zbaton parimet kryesore të së drejtës. Një prej tyre është edhe parimi juridik i cili thekson faktin se gjykata vendos në bazë të akuzave (pretendimeve) dhe provave. Komisioni i Prokurimit Publik, refuzon të vendoset në pozitën e avokatit të ankimuesit e të investohet mbi një ankim i cili nuk mbështetet në asnjë argument.

Rrjedhimisht pretendimet e mësipërme të operatorit ekonomik ankimues, nuk merren në shqyrtim.

III.2. Lidhur me pretendimin e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimues, se: “Sipas pikes 3 te ketij Udhezimi, ne rast se ndonjera nga palet ka komente/pretendime ato duhet te pasqyrohen ne procesverbalin e mbajtur.

KVO ne prezence te perfaqesuesit tone, nuk ka pranuar te pasqyroje ne procesverbalin e mbajtur me ne si BOE, pretendimet tona per parregullsi ne menaxhimin e mostrave, duke mos e marre fare ne konsiderate kerkesen tone e cila eshte ne perputhje me Udhezimin e Agjencise se Prokurimit Publik Nr. 03 date 12.04.2022.

Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (perfaqesuesi/it i autoritetit/enit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t'i vihet në dispozicion ofertuesit/ve .

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur.

Sipas kesaj pike gjithashtu, AK duhet te mbaje procesverbale me te gjithë ofertuesit me qellim sigurimin e transparences dhe integritetin e procesit i cili duhet te dokumentoje procesin e paraqitjes se mostrave, si dhe duhet te pasqyroje detaje qe pershkruajne mostren/at e administruara, nderkohe qe ky procesverbal i cili duhet te nenshkruhet nga palet e pranishme (perfaqesuesi/it i AK dhe ofertuesit/ve) nuk eshte mbajtur nga ana e AK, sipas Udhezimit te APP.

Mostrat e OE Trimed shpk nuk jane administruar sipas udhezimit te APP ne ditën dhe oren e tenderit dhe paketimet e tyre nuk jane verifikuar me detaje nga ana e AK dhe KVO, kjo ne mungese te plote te transparences. Administrimi ne kundershtrim me udhezimin e APP natyrshem ka krijuar kushtet per favorizim te ofertes se OE Trimed shpk duke mos evidentuar mosperputhje te ketyre mostrave me artikujt e deklaruar ne formularin e ofertes, mosperputhje te ketyre mostrave me artikujt e markuar ne katalog, mosperputhje te ketyre mostrave me prodhuesit e deklaruar ne oferte dhe ne autorizime si dhe mosperputhje te ketyre mostrave me produktet e perfshira ne certifikatat perkatese te konformitetit CE.

Bazuar ne Nenin 81 te Ligjit Nr. 162/2020 date 23.12.2020 per Prokurimin Publik (E drejta per informim), ne datën 05.02.2024 ne i jemi drejtuar gjithashtu me nje kerkese autoritetit kontraktor nepermjet postes elektronike (e-mail bashkelidhur) per te na vene ne dispozicion dokumentacionin e paraqitur nga operatori Trimed shpk si Kataloget teknike per te gjithë artikujt e ofruar dhe Procesverbalin e administrimit te mostrave, dhe deri ne datën e paraqitjes se kesaj ankese nuk kemi marre nje pergjigje nga ana e AK. Kërkesa jonë është e përligjur në parashikimet e DST, Shtojca 4 ku citohet se: Nuk konsiderohet se përbën sekret tregtar informacioni që duhet të bëhet publik sipas ligjit, që ka të bëjë me një shkelje të ligjit ose që duhet të publikohet në bazë të praktikave të mira tregtare dlie parimeve të etikës tregtare. Konkretisht: Operatori ekonomik nuk mund të klasifikojë si konfidencial. çmimin e ofertës, listën e cmimeve, katalogun, informacionin lidhur me kriteret e përzgjedhjes se ofertës, dokumentet publike, fragmente nga regjistrat publikë dhe informacione të tjera qe duhet të bëhen publike ose që nuk janë konfidenciale në përputhje me legjisllacionin në fuqi.”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.2.1. Në shtojcën 7 “Kriteret e veçanta të kualifikimit”, “Kapaciteti teknik”, pika 2.3.9, në dokumentet e tenderit të procedurës së prokurimit objekt-ankimi, autoriteti kontraktor ka kërkuar si më poshtë vijon:

2.3.9 Kërkohen të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Gjirokaster, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jo transparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim te rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit te Ofertave te procedurës se prokurimit « Materiale mjekimi te pergjithshme per nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”» dhe jo para datës 23.01.2024 ora 11 :00.

1. - Së bashku me mostrat ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti.
2. - Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1).
3. - Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).

III.2.2. Në nenin 2 “Qëllimi” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se:

Qëllim i këtij ligji është:

- a) të rrisë efikasitetin dhe efikasitetin në procedurat e prokurimit publik;
- b) të sigurojë mirëpërdorim të fondeve publike dhe të ulë shpenzimet procedurale;
- c) të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit publik;
- ç) të nxisë konkurrencën ndërmjet operatorëve ekonomikë;
- d) të sigurojë një trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për të gjithë operatorët ekonomikë, pjesëmarrës në procedurat e prokurimit publik;
- dh) të sigurojë integritet, besim publik dhe transparencë në procedurat e prokurimit publik.

III.2.3. Në nenin 3 “Parime të përgjithshme” të ligjit nr.162/2022 “Për Prokurimin Publik” parashikohet se: “1. Autoritetet dhe entet kontraktore garantojnë trajtim të barabartë dhe jodiskriminues për operatorët ekonomikë, si dhe veprojnë me transparencë e në mënyrë proporcionale. 2. Autoritetet dhe entet kontraktore nuk duhet të shmangin fushën e zbatimit të këtij ligji ose të ngushtojnë në mënyrë artificiale konkurrencën. Konkurrenca konsiderohet se është ngushtuar artificialisht kur prokurimi përgatitet me qëllimin për të favorizuar ose dëmtuar në mënyrë të padrejtë operatorë ekonomikë të caktuar. 3. Autoritetet dhe entet kontraktore janë të detyruara të zbatojnë detyrimet e përcaktuara në legjislacionin mjedisor, social e të punës dhe në dispozitat e marrëveshjeve dhe konventat ndërkombëtare, të ratifikuara në përputhje me Kushtetutën.”

III.2.4. Në nenin 36 “Specifikimet teknike” të ligjit 162/2020 “Për Prokurimin Publik” parashikohet shprehimisht se:

“1. Specifikimet teknike, siç përcaktohen në nenin 4 të këtij ligji, duhet të përshkruhen në dokumentet e tenderit. Në specifikimet teknike përcaktohen qartë karakteristikat e punëve, shërbimit ose furnizimit që do të prokurohet.

Këto karakteristika mund të lidhen edhe me procesin specifik ose metodën e prodhimit ose ofrimit të punëve, furnizimeve ose shërbimeve të kërkuara ose me një proces specifik për një fazë tjetër të ciklit jetësor edhe kur këta faktorë nuk përbëjnë përmbajtjen e saj thelbësore nëse ato janë të lidhura me objektin e kontratës dhe proporcionale me vlerën dhe objektivat e saj. Në specifikimet teknike mund të specifikohet edhe nëse do të jetë i nevojshëm transferimi i të drejtave të pronësisë intelektuale.

Specifikimet teknike, me përjashtim të rasteve të justifikuara plotësisht, hartohen në mënyrë të tillë që të marrin në konsideratë kriteret e aksesueshmërisë për personat me aftësi të kufizuar ose projektimit për të gjithë përdoruesit, sipas kërkesave në legjislacionin në fuqi.

2. Specifikimet teknike duhet të mundësojnë trajtim të barabartë për të gjithë kandidatët dhe ofertuesit dhe të mos shërbejnë si pengesa për konkurrencën e hapur në prokurimin publik.

3. Specifikimet teknike duhet të përshkruajnë qartë kërkesat e autoritetit ose entit kontraktor, duke iu referuar:

a) kërkesave funksionale ose të performancës, përfshirë karakteristikat mjedisore, me kusht që parametrat të jenë të saktë në mënyrë që t’u japin mundësi ofertuesve të përcaktojnë objektin e kontratës dhe autoriteteve ose enteve kontraktore të japin kontratën;

b) standardeve kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimeve teknike ndërkombëtare, specifikimeve teknike të përgjithshme, standardeve ndërkombëtare apo sistemeve të tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit. Kur këto nuk ekzistojnë, ato u referohen standardeve kombëtare, miratimeve teknike kombëtare ose specifikimeve teknike kombëtare, që lidhen me projektimin, përlllogaritjen dhe ekzekutimin e punëve ose përdorimin e produkteve;

c) kërkesave në terma funksionalë sipas shkronjës “a”, referuar specifikimeve teknike sipas shkronjës “b” të kësaj pike, si mënyrë që nënkupton pajtueshmëri me kërkesat funksionale;

ç) të dyja metodave të përcaktuara në shkronjat “a” dhe “b” të pikës 3 të këtij neni, për mallra, shërbime ose punë të ndryshme, të përfshira në të njëjtin objekt kontrate. Çdo referencë duhet të shoqërohet nga fjalët “ose ekuivalenti i tij/saj”.

4. Në specifikimet teknike, nëse nuk e justifikon objekti i kontratës, nuk duhet të përmendet asnjë markë prodhimi ose burim specifik apo proces i veçantë, që karakterizon produktet ose shërbimet e ofruara nga një operator ekonomik specifik apo asnjë markë tregtare, patentë, tipi ose origjinë apo prodhim specifik, me qëllim favorizimin ose eliminimin e disa sipërmarrjeve ose produkteve. Një gjë e tillë lejohet vetëm në raste përjashtimore kur nuk ekziston një mënyrë e mjaftueshme, e saktë apo e kuptueshme e përshkrimit të objektit të kontratës, sipas pikës 3 të këtij neni. Referime të tilla duhet të shoqërohen nga fjalët “ose ekuivalente”.

5. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “b” të pikës 3 të këtij neni, nuk mund të refuzojë një ofertë me argumentin se punët, furnizimet apo shërbimet për të cilat është dorëzuar oferta nuk plotësojnë specifikimet teknike, të cilave u referohen, për sa kohë që ofertuesi provon në ofertën e tij me çdo mjet të përshtatshëm që zgjidhjet e propozuara përmbushin kërkesat e përcaktuara në specifikimet teknike në mënyrë ekuivalente.

6. Në rast se autoriteti ose enti kontraktor përcakton specifikimet teknike në bazë të shkronjës “a” të pikës 3 të këtij neni, ai nuk mund të refuzojë një ofertë për punë, mallra apo shërbime, e cila është në përputhje me standardet kombëtare, që mbështeten në ato ndërkombëtare, miratimet teknike ndërkombëtare, specifikimet teknike të përgjithshme, standardet ndërkombëtare apo sistemet e tjera teknike të referimit, të përcaktuara nga organet ndërkombëtare të standardizimit kur këto specifikime teknike përmbushin kriteret funksionale, të përcaktuara nga autoriteti/enti kontraktor

III.2.5. Në nenin 77 “Kërkesat për kualifikim”, të ligjit nr.162/2020 “Për prokurimin publik”, pika 1 dhe 4, parashikohet shprehimisht se: “1. Autoritetet ose entet kontraktore përcaktojnë kërkesat për kualifikim për operatorët ekonomikë bazuar në: a) përshtatshmërinë për të kryer veprimtarinë profesionale; b) gjendjen ekonomike dhe financiare; c) aftësinë teknike dhe profesionale. Kërkesat kufizohen vetëm në ato që janë të përshtatshme për të garantuar që një kandidat ose ofertues të ketë kapacitetet juridike, financiare dhe aftësitë teknike e profesionale për të zbatuar kontratën që do të jepet. Të gjitha kërkesat duhet të kenë lidhje dhe të jenë proporcionale me objektin e kontratës. 4. Në lidhje me aftësitë teknike dhe profesionale, autoritetet ose entet kontraktore mund të vendosin kërkesa që garantojnë se operatorët ekonomikë zotërojnë burimet e nevojshme njerëzore e teknike, si dhe përvojën e nevojshme për të zbatuar kontratën sipas një standardi të përshtatshëm cilësie”

Në nenin 92 të ligjit Nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, të ndryshuar, parashikohet shprehimisht se:

1. Autoriteti ose enti kontraktor, kur e shikon të arsyeshme, u kërkon ofertuesve sqarime për ofertat e tyre, për shqyrtimin, vlerësimin dhe krahasimin sa më të drejtë të këtyre ofertave. Pa cenuar dispozitat e parashikuara në këtë ligj, nuk duhet të kërkohet, të ofrohet ose të lejohet asnjë ndryshim në përmbajtjen e ofertës, përfshirë ndryshimet në vlerë apo ndryshime që synojnë të kthejnë një ofertë të pavlefshme në të vlefshme.

2. Autoriteti ose enti kontraktor, pavarësisht nga përcaktimi i pikës 1 të këtij neni, duhet të korrigjojë vetëm gabimet aritmetike, që zbulohen gjatë shqyrtimit të ofertave. Autoriteti ose enti kontraktor njofton menjëherë për këto korrigjime ofertuesin që ka paraqitur ofertën. Kur ofertuesi nuk pranon korrigjimin e një gabimi aritmetik, oferta e tij do të skualifikohet.

3. Autoriteti ose enti kontraktor, në zbatim të pikës 4 të këtij neni, vlerëson një ofertë të vlefshme vetëm nëse ajo është në përputhje me të gjitha kërkesat dhe specifikimet e përcaktuara në njoftimin e kontratës dhe në dokumentet e tenderit, pa rënë ndesh me përcaktimet e nenit 38 të këtij ligji.

Oferta konsiderohet e vlefshme edhe nëse ajo përmban devijime të vogla, të cilat nuk ndryshojnë thelbësisht karakteristikat, kushtet dhe kërkesat e tjera, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, gabime shtypi, të cilat mund të korrigjohen pa prekur përmbajtjen e saj, si edhe ato të lidhura me informacionet që merren lehtësisht nga dokumente faktike, që tregojnë gjendjen e operatorit ekonomik në kohën e ofertimit.

III.2.6. Në nenin 40, pika 6, të Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, parashikohet shprehimisht se: Autoriteti/enti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat minimale, të përcaktuara në dokumentet e tenderit, si:

- a) *mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike. Në këtë rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë kërkesën për mostrat. Mostrat duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor. Në rastin e procedurave të zhvilluara me mjete elektronike, autoriteti ose enti kontraktor përcakton qartë procedurën për dorëzimin e mostrave, duke garantuar aksesin e çdo operatori të interesuar si dhe konfidencialitetin për pjesëmarrjen në proces. Mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që kontrata në fjalë të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor. Në rastin kur procedura e prokurimit anulohet, mostrat i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit; dhe/ose*
- b) *fotografitë apo katalogët teknikë; dhe/ose*
- c) *dëshmi për rezultatet e testimeve zyrtare, të lëshuara nga institucione të autorizuar, që vërtetojnë pajtueshmërinë e produkteve me specifikimet teknike.”.*

III.2.7. Në Udhëzimin nr.3, datë 12.04.2022, të Agjencisë së Prokurimit Publik “Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”, APP udhëzon si vijon:

1. *Autoriteti//Enti kontraktor, mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë mostra të mallit, objekt prokurimi, kur gjykon se është e rëndësishme për vlerësimin e aspektit teknik të ofertës. Në çdo rast, autoriteti/enti kontraktor duhet të argumentojë teknikisht vendosjen e kriterit për kualifikim për paraqitjen e mostrave, dhe ky argumentim duhet të pasqyrohet në procesverbalin e argumentimit të specifikimeve teknike dhe kriterëve të veçanta të pranimit, i cili publikohet së bashku me dokumentet e tenderit në Sistemin e Prokurimit Publik (në vijim “SPE).*

2. *Paraqitja e mostrave i shërben autoritetit/entit kontraktor për të gjykuar më mirë mbi përmbushjen e specifikimeve të kërkuara për objektet që prokurohet, me qëllim që, cilësia e mallit të jetë në përputhje me kërkesat e përcaktuara prej tij.*

3. *Për të dokumentuar procesin e administrimit të mostrave, autoriteti/enti kontraktor duhet të mbajë procesverbale, me qëllim sigurimin e transparencës dhe integritetit të këtij procesi.*

Në këtë kuptim, në rastin kur autoriteti/enti kontraktor vlerëson si të nevojshëm dorëzimin e mostrave, në datën dhe në orën e përcaktuar në dokumentat e tenderit për paraqitjen e tyre nga ofertuesit, duhet të mbajë një procesverbal. Procesverbali duhet të dokumentojë procesin e paraqitjes së mostrave, si dhe duhet të pasqyrojë detaje që përshkruajnë mostrën/at e administruara.

Në këtë rast, mbajtja e procesverbaleve i shërben vetëm procesit të paraqitjes së mostrave deri në momentin e kthimit të tyre tek ofertuesit.

Procesverbali i mbajtur me ofertuesin/ofertuesit e pranishëm, i cili duhet të nënshkruhet nga të dyja palët (përfaqësuesi/it i autoritetit/entit kontraktor dhe i ofertuesit/ve), duhet t’i vihet në dispozicion ofertuesit/ve.

Në rast se, ndonjëra nga palët ka komente/pretendime, ato duhet të pasqyrohen në procesverbalin e mbajtur.

4. *Mostrat e paraqitura nga ofertuesit duhet të trajtohen si informacion konfidencial tregtar dhe duhet të jenë në kontroll të autoritetit/entit kontraktor.*

Mostrat e administruara do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, 30 (tridhjetë) ditë pas nënshkrimit të kontratës, me kusht që, kontrata në fjalë, të mos jetë objekt i shqyrtimit administrativ apo gjyqësor.

Në rastin kur, procedura e prokurimit anulohet, mostrat do t'i kthehen ofertuesit, me kërkesën e tij, brenda 30 (tridhjetë) ditëve nga data e marrjes së vendimit përfundimtar të anulimit. [...].”

III.2.8. Kriteret për kualifikim vendosen që t'i shërbejnë autoritetit kontraktor për të krijuar një panoramë të përgjithshme të kapaciteteve dhe mundësisë së operatorit ekonomik për përmbushje me sukses të kontratës. Në varësi të kontratës dhe volumit të saj, autoriteti kontraktor përcakton kërkesat e veçanta për kualifikim, të cilat janë të detyrueshme për t'u përmbushur nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurat e prokurimit. Operatorët ekonomikë janë të detyruar të përgatisin ofertat, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit dhe ofertat që nuk përgatiten në përputhje me këto dokumente duhet të refuzohen si të papranueshme. Gjithashtu, një ndër parimet kryesore të zhvillimit të procedurës së prokurimit është ai barazisë në trajtimin e kërkesave dhe të detyrimeve, që u ngarkohen ofertuesve ose kandidatëve, parashikuar nga neni 3 i ligjit nr. Nr. 162/2020 “Për prokurimin publik”. Zbatimi i parimit të transparencës, barazisë dhe mosdiskriminimit, janë garancitë kyçe ndaj ofertuesve që ofron kuadri ligjor në fuqi. Këto parime ndër të tjera nënkuptojnë, se operatorët ekonomikë duhet të jenë në një pozicion barazie, si kur përgatisin ofertat e tyre, ashtu dhe kur të vlerësohen ato. Operatorët ekonomikë pjesëmarrës në procedurën e prokurimit, me dokumentacionin e dorëzuar, duhet të vërtetojnë, që produkti i ofruar është në përputhje me parametrat dhe specifikimet teknike e kërkuara nga autoriteti kontraktor. Operatorët ekonomikë ofertues marrin përsipër përmbushjen e specifikimeve teknike/kritereve të përcaktuara në dokumentet e tenderit nga ana e autoriteteve kontraktore, nëpërmjet deklaratave dhe dokumentacionit provues në të cilin duhet të faktojnë përputhshmërinë e dokumentacionit me kriteret e përcaktuara nga autoriteti kontraktor, në mënyrë që nga ana e këtij të fundit të mund të kryhet me lehtësi e saktësi vlerësimi i mallrave apo shërbimeve të ofertuara nga operatorët ekonomikë pjesëmarrës, duke përzgjedhur atë ofertues, i cili me dokumentacionin e dorëzuar garanton përputhshmërinë me kriteret e përcaktuara në DT, e rrjedhimisht realizimin me sukses të kontratës objekt-prokurimi.

III.2.9. Nga shqyrtimi në tërësi i fakteve dhe rrethanave të çështjes objekt-shqyrtimi, KPP vëren se autoriteti kontraktor në kriterin e veçantë të kualifikimit, ka kërkuar që nga ana e operatorëve ekonomikë të paraqiten mostra për të gjithë artikujt e ofruar. Dorëzimi i Kampioneve/ mostrave të bëhet pranë Spitalit Rajonal Gjirokastrë, të mbyllura me ngjitëse në zarf/a ose kuti jotransparente të vulosur/a, mbi të cilin/at të shënohet: “Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit « Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)»» dhe jo para datës 23.01.2024, ora 11:00. Gjithashtu është kërkuar, që së bashku me mostrat, ofertuesi duhet të japë edhe një shkresë të vulosur dhe firmosur, ku të listohen mostrat që ndodhen në zarf/kuti. Mbi çdo mostër të dorëzuar, ofertuesi duhet të shënoje Nr. Rendor të Artikullit që përfaqëson sipas formularit të ofertës (shtojca 1). Në paketimin e çdo mostre duhet të evidentohet qartë origjina e mallit, e cila duhet të përputhet me origjinën e deklaruar nga ofertuesi në formularin e ofertës (Shtojca 1).

Referuar informacionit dhe dokumentacionit të depozituar në KPP nga ana e autoritetit kontraktor rezulton, se është dorëzuar dokumenti “Shkresë përcjellëse” për mostrat, datë 23.01.2024, nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK, ku listohen të gjitha mostrat e dorëzuara, të firmosura dhe vulosura nga përfaqësuesi i operatorit ekonomik, sipas kërkesës në pikën 2.3.9/3 të Kapacitetit teknik.

Gjithashtu, nga verifikimi i dokumentacionit të dorëzuar nga autoriteti kontraktor konstatohet, se nga Komisioni i Vlerësimit të Ofertave është mbajtur një procesverbal më datë 23.01.2024, mbi dorëzimin e mostrave nga ofertuesi “Trimed” SHPK, me përmbajtje: *“I mbajtur sot më datë 23.01.2024, ora 11:00, midis komisionit të vlerësimit të ofertave dhe përfaqësuesit të OE Trimed shpk lidhur me dorëzimin e mostrave për procedurën e prokurimit “Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë përcaktuar – me afat 1 vjeçar (12 muaj).*

Mostrat ishin konform specifikimeve teknike dhe listës së mostrave të dorëzuara nga OE Trimed shpk.”.

Ky procesverbal rezulton i firmosur nga të dyja palët, si nga ana e KVO-së së autoritetit kontraktor ashtu edhe nga subjekti ofertues dhe është shoqëruar me listën e mostrave të dorëzuara nga shoqëria “Trimed” SHPK, të vulosur dhe firmosur nga kjo shoqëri.

Nga shqyrtimi i mostrave të shoqërisë “Trimed” SHPK, të paraqitura në KPP nga autoriteti kontraktor, rezulton, se mostrat janë futur në kuti jotransparente të vulosura nga operatori ekonomik “Trimed” SHPK dhe mbi të cilën është bërë shënimi: *“Mos e hapni me përjashtim të rasteve kur është i pranishëm Komisioni i Vlerësimit të Ofertave të procedurës së prokurimit me objekt: Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, marrëveshje kuadër me një operator ekonomik ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara – me afat 1 vjeçar (12 muaj) dhe jo përpara datës 23.01.2024 ora 11:00”.*

Komisioni sqaron, se autoriteti kontraktor mund t’u kërkojë operatorëve ekonomikë të dorëzojnë dëshmi, që tregojnë se ata i plotësojnë kërkesat e përcaktuara në dokumentet e tenderit, të tilla si mostra të mallit, kur e gjykon se kjo ka rëndësi për vlerësimin e ofertës teknike sikundër është kërkuar në këtë procedurë prokurimi. Mostrat - referuar edhe legjislacionit në fuqi, i shërbejnë autoritetit kontraktor për të vlerësuar nëse një operator ekonomik ka kapacitete për të ofruar produktin e kërkuar nga autoriteti kontraktor.

Nisur nga pretendimet e ankimesit rezulton, se nga ana e autoritetit kontraktor është dokumentuar procesi i administrimit të mostrave, duke mbajtur procesverbalin përkatës, i cili rezulton të jetë i nënshkruar nga të dyja palët, nga KVO-ja dhe përfaqësuesi i ofertuesit objekt-ankimimi. Ky procesverbal është shoqëruar edhe me listën e mostrave të paraqitura nga “Trimed” SHPK, në përputhje me kërkesat e autoritetit kontraktor si më sipër cituar.

Sa më sipër, gjykojmë, se autoriteti kontraktor ka administruar procesin e dorëzimit të mostrave në përputhje me Udhëzimin nr.3, datë 12.04.2022, të Agjencisë së Prokurimit Publik *“Mbi procesin e administrimit të mostrave të paraqitura nga operatorët ekonomikë”.*

Sa më sipër, pretendimet e bashkimit të operatorëve ekonomikë ankimes nuk qëndrojnë.

Për sa më sipër, në mbështetje të neneve 30, dhe 118 të ligjit nr. 162/2020 “Për Prokurimin Publik”, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 285, datë 19.05.2021 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 236, datë 20.04.2023, “Për përcaktimin e rregullave dhe tarifës së pagesës për ankimin në një procedurë prokurimi pranë Komisionit të Prokurimit Publik”, Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik Nr. 766, datë 13.10.2021 “Për miratimin e rregullave “Për Organizimin dhe Funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, nenit 4, të Vendimit të Komisionit të Prokurimit Publik nr. 500/2020 datë 5.11.2020 “Rregullore për Marrjen e Masave Organizative për Ushtrimin e Veprimtarisë së Institucionit të Komisionit të Prokurimit Publik gjatë gjendjes së pandemisë së shkaktuar nga COVID -19”, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos:

1. Të mos pranojë ankesën e bashkimit të operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK për procedurën e prokurimit “Procedurë e hapur, e thjeshtuar”, me Nr. REF-93011-01-11-2024, me objekt: “Materiale mjekimi të përgjithshme për nevoja spitalore, Marrëveshje Kuadër me një operator ekonomik, ku të gjitha kushtet janë të përcaktuara - me afat 1 vjeçar (12 muaj)”, me fond limit 7,137,795 lekë (pa TVSh), zhvilluar në datën 23.01.2024, nga autoriteti kontraktor, Drejtoria e Spitalit Rajonal Gjirokastër.
2. Autoriteti kontraktor lejohet të vijojë me hapat e mëtejshëm të procedurës së prokurimit.
3. Ngarkohet zyra e financës të kryejë veprimet përkatëse për derdhjen në Buxhetin e Shtetit, të tarifës financiare të paguar nga bashkimi i operatorëve ekonomikë “Biometric Albania” SHPK & “Montal” SHPK.
4. Kundër këtij vendimi mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative të Apelit.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Kreshnik Ternova

Anëtar
Anila Malaj

Kryetar
Jonaid Myzyri

